




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE



Adresa: Bul.Gj. Fishta,Rr.Nikolla Jorga,Kulla Nr.8, Shk. 5 / 9 / 37,Tirane
Nr. 348 / Regj. Nr. 200 Prot

Tel +355 69 68 97 406
Tiranë më, 24. 10. 2022

**URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE**

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit
Adresa : Bulevardi “ Zhan D’Ark” Nr.33, Tiranë

Unë Altin Semeu, përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbartimore Private “TIRANA” pasi studiova materialet e dosjes përmbartimore Nr. 348 Regj.

KONSTATOVA:

Se është depozituar pranë Zyres Përmbartimore Private TIRANA kërkesa e palës kreditore për ekzekutim të Vendimit “Per lëshimin e urdhrit të ekzekutimit” Nr. 12021 Regj.Them, datë 22.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar për titullin ekzekutiv :Fatura Tatimore Nr. 30 date 25.09.2021 me vlerë 100.875 leke me TVSH. - Fatura Tatimore Nr. 41 date 15.10.2021 me vlerë 28.800 leke me TVSH, Fatura Tatimore Nr. 44 date 21.10.2021 me vlerë 288.800 leke me TVSH, të leshuara nga pala kreditore shoqëria “B&A-02” sh.a., me NIPT K2172007H, për debitorin shoqëria “Lalzi Marina”, me NIPTM11530503E, me palë dhe objekt:

Kreditor : Shoqëria “B&A-02” sh.a., NIPT K2172007H
Debitor : Shoqëria “ LALZI MARINA ” , NIPT M11530503E
Me objekt : Likuidim detyrimi

Në kushtet pala debitore nuk ka përmbushur detyrimin sipas titullit ekzekutiv dhe për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit, duhet të vendoset masa e sekuestros konservative dhe bllokimi i kuotave / aksioneve si dhe e të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tyre, me qëllim mostjetërsimin dhe shmangien nga detyrimet sipas titullit ekzekutiv të sipercituar si dhe në zbatim të nenit 519,527,e vijues të K.Pr.Civile, ligjit nr. 26/2019 “ Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”

URDHËROJ

Vendosjen e sekuestros konservative dhe bllokimit të kuotave / aksioneve dhe e të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave për debitorin :

1. Shoqëria “ LALZI MARINA ” , NIPT M11530503E, administrator z. Redi Peza dhe z. Hergys Rreli, me adresë Fshati Hamallaj, Kompleksi Valamar, Blloku D, Ap.10, Hamallaj, Durres
2. Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje me procedurën e vënies së sekuestros nga ana juaj.
3. Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
4. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbartimor i referuar në K.Pr.Civile, palët mund të paraqesin ankim në Gjykatë, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.

Zyra Përmbartimore Private Tirana
Përmbartues Gjyqësor
Altin SEMEU

